

## BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL PJESË E RËNDËSISHME E PROCESIT TË AUDITIMIT

*nga Nikoleta PIRANJANI<sup>1</sup> – Audituese e Lartë,  
botuar në gazetën “55”, më 07 maj 2015.*

Duke qenë pjesë e grupeve të auditimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH rezultuar nga veprimtaria audituese e vitit 2014, rezultateve të zbatimit të tyre në institucione të ndryshme si dhe referuar eksperiencës disavjeçare në fushën audituese mendoj se janë të rëndësishme në këtë proces dy aspekte kryesore:



I pari dhe shumë i rëndësishëm, të kuptuarit nga institucionet publike, të rolit shumë të rëndësishëm kushtetues të KLSH, si institucion i pavarur, ligjor në auditimin e veprimtarisë të institucioneve buxhetore e publike me kapital tërësisht ose pjesërisht shtetëror në drejtim të përdorimit me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve buxhetore mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Së dyti dhe jo pak i rëndësishëm, për një menaxhim funksional dhe realizim të detyrimit kushtetues të funksioneve të KLSH-së, të cituara më sipër, është bashkëpunimi ndërinstytucional midis institucioneve dhe KLSH-së.

Standardet e INTOSAI-t dhe implementimi i tyre në procedurat e punës audituese të KLSH, japin të gjitha hapësirat dhe mundësitë që ky bashkëpunim të jetë real dhe funksional.

Nisur nga rezultatet e zbatimit të rekomandimeve, gjatë verifikimit në disa institucione, rezultoi se kishin impenjimin maksimal të vënies në zbatim të rekomandimeve të lëna nga auditimi dhe këtë angazhim e kishin marrë që në momentin e lënies së rekomandimeve dhe gjithashtu kishin disponibilitetin për të argumentuar me dokumentacion çdo masë të marrë ose në proces të zbatimit të rekomandimeve. Kurse disa të tjerë nuk ishin të impenjuar, ose ishin të angazhuar formalisht në këtë proces, pa marrë masat dhe kryer analizat përkatëse, që çojnë domosdoshmërisht në zbatimin e tyre. Duhet theksuar se disa prej institucioneve në mënyrë të pakuptimtë, paraqisnin observacionet personale të punonjësve për të argumentuar mos realizimin e rekomandimeve të lëna, proces ky që mbyllet me fazën e auditimit dhe para dërgimit të raportit përfundimtar me konkluzionet përkatëse. Kjo tregon se këto faza ballafaqese nuk kanë funksionuar si duhet. Institucionet kanë qenë indiferente për të mbrojtur me argumente në kohën e duhur konkluzionet e KLSH dhe për rrjedhojë në mos kuptimin dhe mos zbatimin e rekomandimeve të KLSH. Në këndvështrimin tim, ky rezultat paraqet përgjegjësi institucionale, mos funksionim të hallkave dhe të strukturave, mos funksionim të kërkesës së llogarisë dhe për rrjedhojë të mos kuptuarit të rëndësisë së funksioneve audituese të KLSH-së.

Natyrshëm lind pyetja a ka vend për përmirësim në këtë drejtim? Domosdoshmërisht që po, nga të gjithë aktorët në këtë proces. Por mendoj se një rol shumë të rëndësishme në këtë proces ka Institucioni i KLSH, me audituesit, gjatë procesit tonë të auditimit, që me këmbëngulje dhe mënyrë të vazhdueshme të kërkojmë zbatimin deri në fund të rekomandimeve të lëna. Pjesë e rëndësishme e këtij procesi është dhe rritja e cilësisë së rekomandimit, formulimit në mënyrë të kuptueshme të tij, dhe mbi të gjitha marrja domosdoshmërisht e mendimit paraprak të institucionit mbi rekomandimin, ndërgjegjësimit të tij për dhënien e këtij opinioni (ky është një standard që përgjithësisht nuk zbatohet nga institucionet, të cilët nuk japin opinione konkrete për rekomandimet e lëna paraprakisht edhe kur janë dakord ose në të kundërt).

Gjatë auditimit të institucioneve më kanë bërë përshtypje disa prej tyre për gatishmërinë institucionale për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, seriozitetin në masat e marra dhe ndjekjen e tyre, nxjerrja e urdhrave dhe udhëzimeve, në mënyrë që këto rekomandime të jenë pjesë e proceseve dhe rregulloreve të punës. Gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve ndjeva predispozicionin institucional të këtyre institucioneve për bashkëpunim dhe vlerësim të detyrave kushtetuese të KLSH dhe kjo më bëri të ndjehem mirë si punonjëse e këtij institucioni, por dhe më mirë si qytetare e këtij vendi.

Në këtë këndvështrim do të dëshiroja që zbatimi në praktikë i masave të marra institucionalisht dhe kontrolli në vazhdimësi i tyre të ishte pjesë e punës së vazhdueshme të strukturave të këtyre institucioneve, për të ndryshuar dhe përmirësuar atë që është arritur aktualisht. Ndryshimet pozitive në veprimtarinë e institucioneve shtojnë shpresën se gjërat po

funksionojnë dhe domosdoshmërisht do të ndryshojnë për mirë, kur ka bashkëveprim, ndërgjegjësimit institucional, kur ka sy të hapur dhe mendje të hapur për të bërë ndryshimin pozitiv. Sigurisht kjo kërkon dhe impenjimin maksimal të gjithkujt në pozicionin e tij të punës për një ndërgjegjësimit për kryerjen ligjore dhe me përkushtim të saj, për të mirën e të gjithëve.

---

<sup>1</sup> Shkrime të tjera të botuara nga Nikoleta PIRANJANI për periudhën janar–qershor 2015:

- *KLSH dhe fondet publike.*

*(Botuar në gazetën "Telegraf", më 16 qershor 2015.)*